



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Berat më ____/____/2023

RELACION

PËR SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2023 TË BASHKISË BERAT ME FONDIN PËR RITJEN E PAGAVE NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 328, DATË 31.05.2023

Të nderuar këshilltarë !

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.328 datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”,

Bashkisë Berat, me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.12674 datë 10.07.2023 “Dërgohet akordimi i fondit për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023”, i është akorduar fondi prej 17,533,008 lekë si Transferte korrente e brendshme (art. 604) , për rritjen e pagave të punonjësve të cilët preken nga ky vendim.

Është e nevojshme që ky fond të detajohet në zërat e shpenzimeve Paga dhe Sigurime Shoqërore&Shëndetësore, si edhe të rishpërndahet dhe shtohet në buxhetin e vitit 2023 të njësive shpenzuese :

1. Bashkia Berat (qendra), total shtesa 4,522,303 lekë, nga të cilat: në programin buxhetor 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim” shuma 3,501,000 lekë , në programin buxhetor 10430 “Përkujdesja Sociale” shuma 1,021,303 lekë.
2. Agjencia e Shërbimeve Publike , total shtesa 5,085,000 lekë, nga të cilat: në programin buxhetor 04520 “Rrjeti rrugor rural” shuma 2,685,000 lekë , në programin buxhetor 06260 “Shërbimet publike vendore” shuma 2,400,000 lekë.
3. Drejtoria Arsimore Bashkia Berat, total shtesa 6,765,705 lekë, nga të cilat: në programin buxhetor 09120 “Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor” shuma 5,464,500 lekë, në programin buxhetor 09230 “Arsimi i mesëm i përgjithshëm/parauniversitar” shuma 641,850 lekë, në programin buxhetor 10430 “Përkujdesja Sociale” shuma 659,355 lekë
4. Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve , Ujërave dhe Shërbimit Veterinar, total shtesa 1,160,000 lekë, nga të cilat: në programin buxhetor 04240 “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit” shuma 750,000 lekë, dhe në programin buxhetor 04260 “Administrimi i pyjeve dhe kullotave” shuma 410,000 lekë.

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54, gërma “dh”, neni 64 gërma “c”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar , të ligjit nr. 84/2022 “Për Buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit plotësues nr. 2 datë 19.01.2023 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”; Vendimit e Këshillit Bashkiak nr 100 datë 22.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025” i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.328 datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

12674 datë 10.07.2023 "Dërgohet akordimi i fondit për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023",

propozojmë që në VKB nr 100 datë 22.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025" i ndryshuar, të bëhet shtesa e buxhetit të vitit 2023 si më poshtë :

1. Të shtohet buxheti i vitit 2023 me 17,533,008 lekë me fondin për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023.

Detajimi i shtesës së buxhetit :

Shtesë:

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Llogaria	Kod Projekti	Pershkrimi	Shuma LEK
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				4,522,303
		01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim			3,501,000
2102001	01	01110	600	9999999	Paga	3,000,000
2102001	01	01110	601	9999999	Sigurime shoqerore	501,000
		10430	Përkujdesja Sociale			1,021,303
2102001	01	10430	600	9999999	Paga	862,000
2102001	01	10430	601	9999999	Sigurime shoqerore	159,303
2102004		Agjencia e Shërbimeve Publike				5,085,000
		04520	Rrjeti rrugor rural			2,685,000
2102004	01	04520	600	9999999	Paga	2,300,000
2102004	01	04520	601	9999999	Sigurime shoqerore	385,000
		06260	Shërbimet publike vendore			2,400,000
2102004	01	06260	600	9999999	Paga	1,500,000
2102004	01	06260	601	9999999	Sigurime shoqerore	900,000
2102005		Drejtoria Arsimore Bashkia Berat				6,765,705
		09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor			5,464,500
2102005	01	09120	600	9999999	Paga	4,650,000
2102005	01	09120	601	9999999	Sigurime shoqerore	814,500
		09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm			641,850
2102005	01	09230	600	9999999	Paga	550,000
2102005	01	09230	601	9999999	Sigurime shoqerore	91,850
		10430	Përkujdesja Sociale			659,355
2102005	01	10430	600	9999999	Paga	565,000
2102005	01	10430	601	9999999	Sigurime shoqerore	94,355
2102022		Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve , Ujërave dhe Shërbimit Veterinar				1,160,000
		04240	Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit			750,000
2102022	01	04240	600	9999999	Paga	600,000
2102022	01	04240	601	9999999	Sigurime shoqerore	150,000
		04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave			410,000
2102022	01	04260	600	9999999	Paga	320,000
2102022	01	04260	601	9999999	Sigurime shoqerore	90,000
					Totali i Shtesave	17,533,008

Ju faleminderit !

KRYETAR

Ervin DEMO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Agjencia e Shërbimeve Publike

Drejtoria Arsimore Bashkia Berat

Drejtoria e Bujqësisë

Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

Drejtoria Juridike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, TRANSPORTIT, SHËRBIMEVE DHE
PRONAVE

RELACION

MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHTETIT
TË MBROJTJES CIVILE

Të nderuar këshilltarë!

Nisur nga verifikimet në teren të zonave të riskut të cilat përbejnë rezik për jetën e qytetarëve, si dhe kërkesave të vazhdueshme të tyre për rrezikshmërinë që paraqesin muret mbajtëse të rrugëve në lagjen “28 Nëntori” dhe lagjen “Donika Kastrioti”, të Bashkisë Berat konkretisht :

- Lagjja “ 28 Nëntori “ Rajoni nr 2, ka patur rrëshqitje të rrugës së lagjes ku kalojnë disa familje . Si pasojë e rrëshqitjes në një gjatësi prej 17 ml rruga aktualisht është bërë e pakalueshme për automjetet e vogla të cilat janë shume të domosdoshme pasi ne kete rrugë kalojnë familje që kanë persona me aftësi të kufizuar .siç është rasti i familjes së Xhela Bregut.
Shembja e murit ekzistues të kësaj rruge ka rrezikuar edhe banesën e znj.Monda Shabanit siç duket edhe nga fotot që janë bashkëlidhur relacionit.
- Lagjja “ Donika Kastrioti “ , Rruga “Vangjel Zoto” Rajoni 3 kemi rrëshqitje të aksit të rrugës në gjatësinë prej 20ml ,si rezultat i terrenit dhe kalimit të automjeteve të vogla dhe të mëdha . Dëmtimi i rrugës po vazhdon akoma prandaj del e nevojshme ndërtimi i murit mbajtës të kësaj rruge .

Në mbështetje të ligjit nr 45/2019 “ Për mbrojtjen civile” dhe të VKM nr 414 datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” pika 3.1 gërma b, pika 5 , shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes nr 86/6 prot datë 27.03.2023” Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2023” ku Bashkise Berat i është akorduar fondi në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, TRANSPORTIT, SHËRBIMEVE DHE
PRONAVE

shumën 12,669,893.43 lekë, ju sjellim propozimet tona për të përdorur fondin e akorduar nga buxheti i shtetit për mbrojtjen civile si më poshtë :

- të përdoret shuma 269,275.00 (dyqind e gjashtedhjet e nëntë mijë e dyqind e shtadhjet e pese) lekë për projektin “ Mur mbajtes Rruga “Vangjel Zoto””, dhe 529,214.00 (pesëqind e njëzet e nëntë mijë e dyqind e katërmbëdhjet) lekë sipas preventivave bashkangjitur relacionit.

Këto ndërhyrje shërbejnë për marrjen e masave parandaluese, mos lejimit e shkatërrimit të mëtejshëm të rrugëve dhe rikthimin e jetës normale për komunitetin dhe veprimtaritë e tij ekonomike , në përputhje me pikën 3.1 gërma b të VKM-së.

Ju faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË

Ervin DEMO

Drejtoria e MCPTSH

Drejtoria e PULMI

Drejtoria Juridike

Drejtoria e Menaxhimit Financiar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

R E L A C I O N

**“MBI MIRATIMIN E FONDEVE PËR NDËRHYRJEN EMERGJENTE TË
PROJEKTIT “NDËRTIMI I SHPATULLAVE TË URES NË FSHATIN LAPARDHA”**

Të nderuar Këshilltarë!

Në bazë të VKM 753 datë 09/12/2021 për shpronësimin për interesa publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, po realizohet projekti për kthimin e Bazës Ajrore Kuçovë, në Bazë Ajrore Taktike të NATO-s. Nga ky projekt u prekën shumë toka bujqësore të fshatit Moravë, nga të cilat rreth 25 ha tokë bujqësore dhe 2.2 ha sera diellore ngelin pa rrugë, sepse gardhi i ri i vendosur nga projekti e pret këtë rrugë. Zgjidhja e vetme do të ishte që këto toka të lidheshin me një Urë mbi lumin lapardhica që lidh Lapardhanë me Moravën, dhe do të bënte të mundur kalimin e fermerëve në tokat e tyre. Ura do të jetë e pozicionuar mbi lumë, dhe do të përbëhet nga shpatulla anësore me hapësirë drite 20 m. Preventivi i hartuar për Objektivin: “Ndërtimi i shpatullave të ures në Lapardha Bashkia Berat” është 9 365 037.72 leke me tvsh. Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve ka hartuar projekt preventivin për: “Ndërtim i shpatullave të Ures në Lapardha”, në Njësinë Administrative Otllak .

Në mbështetje të ligjit nr 45/2019 “ Për mbrojtjen civile” dhe të VKM nr 414 datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” pika 3.1 gërma b, pika 5 , shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes nr 86/6 prot datë 27.03.2023” Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2023” ku Bashkisë Berat i është akorduar fondi në shumën 12,669,893.43 lekë, ju sjellim propozimet tona për të përdorur fondin e mbetur të akorduar nga buxheti i shtetit për mbrojtjen civile në shumën 4,298,156.00 dhe pjesën tjetër në shumën 5,066,881,72 nga Buxheti i Bashkisë.

Këto ndërhyrje shërbejnë për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese , mbrojtëse dhe rehabilituese në objektet infrastrukturore që përbëjnë një kërcënim serioz për jetën e njerëzve, pronave të tyre dhe mjedisin, të cilat ndikojnë në rikthimin e jetës normale për komunitetin dhe veprimtaritë e tij ekonomike , në përputhje me pikën 3.1 gërma b të VKM-së.

Bashkangjitur projekti me objekt “ Ndertimi I shpatullave të Ureës së Lapardhasë “

Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Transportit, Pronave dhe Shërbimeve

Erlin Kuçi

Drejtoria e Planifikimit Urban , Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve

Luçiano Bojaxhiu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

PËR MIRATIMIN E STUDIMIT DHE FONDIT PËR SHËRBIMET SHITESË TË PASTRIMIT DHE
TRANSFERIMIN E TYRE NË SHA "BERAT CITY GREEN" SHOQËRI AKSIONARE ME 100% TË
AKSIONEVE TË BASHKISË BERAT

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkia Berat ka përgatitur Studimin për shërbimet shtesë të pastrimit të cilat përfshijnë shërbime që nuk janë parashikuar në kontratë aktuale me kompaninë sipërmarrëse për shërbimet e pastrimit në qytet.

Studimi përfshin shërbimet shtesë të pastrimit në lagjet muzeale dhe shtratin e lumit, mirëmbajtjen e vend-depozitimit dhe riciklimin e mbetjeve urbane në qytetin e Beratit.

1-Shërbime pastrimi në lagjet muzeale.

Studimi për përcaktimin e kostos vjetore për shërbimin e mirëmbajtjes dhe pastrimit të rrugicave në lagjet muzeale Mangalem, Goricë, Kala dhe Shtratin e Lumit është punuar duke marrë në konsideratë përgjegjësin për krijimin e kushteve më të mira dhe plotësimin me bazë materiale të domosdoshme për rritjen e shërbimit. Forma e dhënies së shërbimit të mirëmbajtjes në zonat muzeale nëpërmjet Bashkisë Berat është më efiçente dhe më cilësore. Për shkak të mungesës së kryerjes së shërbimit në këto zona në kontratën aktuale të pastrimit me nr. Prot 2241, dt. 25.04.2019, ky shërbim i ri do të përfshijë gjithë territorin e sipërcituar nga ku do të ofrojnë shërbime shtesë.

Gjithashtu që nga viti 2019 që ka filluar kontrata e Shërbimit të Pastrimit është shfaqur si problematik nevoja për zgjerime të sipërfaqeve të mirëmbajtjes dhe pastrimit në zonat muzeale, realizimi i të cilit ka qënë një domosdoshmëri duke shkaktuar probleme me menaxhimin e mbetjeve. Studimi i kryer është realizuar duke marrë parasysh përditësimet ligjore për kostot dhe pagat.

Me rritjen e fluksit turistik, Bashkia Berat numëron në periudhën Janar- Nentor 2023 rreth 750,000 turistë, dyfishi i numrit të turistëve krahasuar më të njëjtën periudhë të vitit 2022. Ky

fluks turistik bën të domosdoshëm shtrirjen e shërbimeve të pastrimit në lagjet muzeale dhe zonën e mbrojtur, duke përmirësuar ndjeshëm imazhin e qytetit.

2.Shërbimet për Venddepozitimin:

Nisur nga investimi i rehabilitimit të sheshdepozitimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Berat i cili u realizuar me mbështetjen e Qeverisë së Zvicrës nëpërmjet SECO kërkohet mirëmbajtje e vazhdueshme e venddepozitimit në proceset e punës që aty realizohen, procese të cilat nuk janë të përfshira në kontratën aktuale (të sipër përmendur).

3. Shërbimet për Riciklimin e mbetjeve urbane

Bashkia Berat me mbështetjen e Ambasadës Suedeze, nëpërmjet Agjensisë Suedeze për Zhvillim SIDA, është përfituese e Projektit “ Ndarja e mbetjeve në burim në qytetin e Beratit”.

Projekti zbatohet në përputhje me VKM Nr. 418, datë 25 Qershor 2017 “Për Ndarjen e mbetjeve në burim”, synon të përcaktojë masat për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar, për uljen e sasisë totale të mbetjeve të dërguara për trajtim përfundimtar.

Objekti i përgjithshëm i këtij projekti është t’i ofrojë qytetit të Beratit skemën të ndarjes së mbetjeve shtëpiake në burim dhe përmirësimin e standardeve mjedisore dhe praktikave të menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Berat.

Ky projekt përmes grumbullimit të ndarë në burim të mbetjeve të riciklueshme synon të lehtësojë rritjen e sasive dhe cilësisë së materialeve të ricikluara dhe të rikuperuara nga mbetjet shtëpiake.

Vitin e parë të shërbimit , riciklimi do ofrohet si shërbim me staf të reduktuar, për t’u plotësuar më pas, duke u bazuar në të ardhurat që do gjenerojë si shërbim.

Kostoja e shërbimeve shtesë për 3 shërbimet më sipër është parashikuar sipas studimit në vlerën **20,202,625 lekë me TVSH.**

Bashkia Berat këto fonde në shumën **20,202,625 lekë** do t’ia kalojë SHA “ Berat City Green” , shoqëri me kapitale 100% të Bashkisë Berat, për të menaxhuar shërbimet shtesë të pastrimit sipas tre komponentëve më sipër dhe bazuar në Studimin e përgatitur nga grupi i Punës i Bashkisë Berat.

Ju faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË

Ervin DEMO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

**DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE TRANSPORTIT PRONAVE DHE
SHERBIMEVE**

RELACION

**“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË BERAT, SË BASHKU ME
DOKUMENTACIONIN TEKNIKO - LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS
FINANCIARE PËR FAMILJET BANESAT E TË CILËVE JANE DËMTUAR NGA
ZJARRI, NGA BUXHETI I BASHKISË I VITIT 2023, PROGRAMI “ EMERGJENCAT
CIVILE”**

Të nderuar këshilltarë,

Në datën 28.08.2023 nga zjarri i renë u demtua banesa e ndodhur në Fshatin Osmenzeze, Njësia Administrative Sinjë ,Bashkia Berat .

Pas arkivimit të kërkesës së shtetasit Mikail Cuka (nipi i Bilbil Baza) dt.31.08.2023, Komisioni i Emergjencave i ngritur me Urdhërin Nr.561 datë 14.09.2023 të Kryetarit të Bashkisë , shkoi ne vendngjarje dhe në bazë të konstatimit fizik, hartoi proces verbalin e dëmeve të shkaktuara, mbështetur në VKM Nr.329, date 16.05.2012 “Per kriteret per procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore“

Proces verbali i konstatimit u percollë në Këshillin e Qarkut me shkresën Nr.4648 Prot, datë 18.09.2023 për vlerësimin e dëmeve sipas ligjit.

Komisioni i Ekspertëve të Këshillit të Qarkut,ka përfunduar vlerësimin e dëmeve të shkaktuara banesën e Z. Bilbil Bazaj dhe është përcjellë në Bashkinë Berat me Nr. 839/1 Prot, date 01.11.2023. . Në

mbështetje të preventivave të hartuara nga grupi i eksperteve dërguar në Bashkinë Berat rezultojnë dëmet :

1. Ne banesën e shtetasit Bilbil Bazaj vlerën 791 385 lek .

- Punime ndërtimore në vlerën 533 385 lek

- Orendi dhe pajisje 258 000 lek

Bazuar në dokumentacionin që disponojmë , në VKM Nr.329 datë 16.05.2012 shkronjen “ ç”, të pikës 1, të kreut III; i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë vlerën e ndihmës së menjëherëshme financiare për:

Z. Bilbil Bazaj në vlerën **395692 lek**

Ndihma financiare do të përballohet nga fondet e emergjencës së Bashkisë për sigurimin e jetës dhe kushteve të përkoheshme të jetesës , si dhe për shpenzime të tjera për përballimin e situatës emergjente .

DREJTORI MCTPSH

Erlin Kuçi



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

R E L A C I O N

PËR

**HEQJEN E PËRKOZHSHME TË DEPOZITAVE TË UJIT NGA PALLATET E
BANIMIT DHE HEQJEN E MENJËHERSHME NGA OBJEKTET E DËMTUARA
QË PARAQESIN RREZIK PËR JETËN DHE SHËNDETIN E NJERËZVE**

Bashkia Berat me qëllim ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave që i ngarkon legjislacioni në fuqi, për realizimin e shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë propozon heqjen e përkohshme të depozitave të ujit nga pallatet e banimit dhe heqjen e menjëhershme nga objektet e dëmtuara që paraqesin rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Tërmeti i fuqishëm i rënë në datën 26.11.2019, që tronditi Shqipërinë, përfshiu edhe territorin administrativ të Bashkisë së Beratit, ku janë evidentuar dëme të shumta ndërtimore në të gjitha Njësitë Administrative në juridiksionin e saj administrativ. Neni 29, pika 3, e ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ka përcaktuar si një nga funksionet dhe përgjegjësitë kryesore të njësive të vetëqeverisjes vendore në fushën e sigurisë publike garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, si dhe parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet.

Nëpërmjet këtij projektvendimi, Bashkia Berat propozon e hartimin e një akti standart për heqjen e depozitave të ujit nga tarracat. Sipas parashikimeve të këtij projektakti, propozojmë marrjen e masave të menjëhershme për heqjen e depozitave të ujit nga tarracat e pallateve që nga akt konstatimet paraprake të Institutit të Ndërtimit apo grupet përkatëse të inspektimit, janë shpallur të banueshme apo banorët e tyre janë evakuuar për shkak se godinat kërkojnë një rivlerësim të thelluar mbi gjendjen e tyre strukturore.

Kurse,

Sipas parashikimeve të këtij projektvendimit, propozojmë që të hiqen të gjitha depozitat e ujit nga tarracat, jo për t'i lënë pa alternativë, por që në bashkëpunim me administratorët e pallateve të kenë mundësi si pallatet e reja, në hapësirën e përbashkët në katin e parë ose në një nga vendet e parkimit, të kenë mundësi të instalojnë një depozitë të përbashkët të të gjithë

banorëve jo secili të vetën, që rrezikon kryesisht vatëm ata që janë katet e fundit, që janë të parët të prekur nga tarraca.

Bashkia Berat do të lejojë që depozitat në tarracë vetëm nëse inxhinierë konstruktorë të licencuar i japin aprovim administratorit të pallatit se tarraca .

Nisur nga rënia e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, e cila krijoi një situatë të papritur me pasoja të rënda për banorët e Bashkisë Berat, duke cënuar sigurinë e tyre dhe shkaktuar dëme të mëdha për jetën e njerëzve, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, në të cilin është sanksionuar fakti se për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë. Sipas këtij vendimi, institucionet publike janë të detyruara të marrin masa të jashtëzakonshme për përballimin e kësaj situate. Konkretisht, referuar pikës 7.1, shkronjat “a” dhe “d” institucionet publike duhet të realizojnë plane masash organizative dhe administrative për përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe ndihmojnë në përballimin dhe lehtësimin e saj.

Duke shpresuar në miratimin e këtij projekt vendimi nga ana juaj,

Pergatiti Drejtori Z._____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

RELACION

**MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË PËR MBULIM TVSH TË PROJEKTEVE TË BASHKISË BERAT ME FINANCIM TË HUAJ.
(shtesë buxheti me fondin për shpenzime kapitale për pagesë TVSH)**

Të nderuar Këshilltarë ,

Bashkia Berat, në zbatim të ligjit Nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” ,të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 2 datë 19.01.2023 “ Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, ka kërkuar mbështetje me fonde për bashkëfinancimet dhe mbulimin e kostos së TVSH për projektet e ndihmës suaj pranë Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës në Kryeministri (SASPAC).

Agjensia SASPAC dhe Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka miratuar kërkesën e Bashkisë Berat për mbulimin e TVSH për buxhetet e projektet e huaja si vijon:

1-Fond për pagesën e TVSH për projektin “ Culture Lands “ ,Programi 8220 “Trashegimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore”, Kodi i produktit 90005AD, Shuma 117,894 Lekë.

Projekti “ Culture Lands “ financohet nga Komisioni Europian Fondet IPA Shqiperi Greqi me kontributin 15% të bashkëfinancimit të Bashkisë Berat .

2-Fond për pagesën TVSH për projektin “Shërbime multifunksionale në sektorin e arsimit” Programi 9120 “Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor” ,Kodi i produktit 09120 , shuma G102009 Lekë.

Projekti më sipër ka realizuar ndërhyrje rehabilituese në ish-godinën e SHIK, për t’a kthyer në një Qendër për Shërbimet Arsimore të Bashkisë Berat, rehabilitim të pjesshëm të kopshtit Moravë dhe Shkollës së Mesme Dyshnik, dhe disa aktivitete të lidhura me shërbimet më sipër, si blerje mjetesh didaktike për kopshtet dhe aktivitete vizibiliteti. Projekti financohet nga Programi BE për Bashkitë i Komisionit Europian dhe bashkëfinancim të Bashkisë Berat.

3- Fond për pagesën TVSH për projektin “Shërbime multifunksionale në sektorin e arsimit” Programi 9120 “Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor”, Kodi i produktit 09120 , shuma G102009 Lekë.

Fondet që do përdoren nga granti i ardhur nga MFE janë me destinacion të përcaktuar si më sipër. Bashkia Berat në këtë mënyrë kursen nga buxheti i saj fondet në shumën 1,839,947 lekë,të cilat ishin parashikuar për mbulim TVSH për vitin 2023 për projektet më sipër.

Kërkojmë miratimin nga ana juaj të përdorimit të fondeve të MFE për projektet më sipër.

Faleminderit,

DREJTORE E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PROJEKTEVE

Etleva Dhima

DREJTORE E FINANCË BUXHETIT

Rovena Shehu